



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 50/09

Prishtinë, më 8.05.2009, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Riza Smaka, Müfera Şinik, Besa Gaxherri, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj, Naser Osmani,**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit : Safete Hadërgjonaj, Haki Shatri.

Nga stafi mbështetës i Komisionit : Vilson Ukaj, Dashurie Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), Gazmend Avdyli (praktikant)

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Argjentina Grazhdani kryetare e këshillit të KPM-së, Lars Lage Olofsson auditor i përgjithshëm i ZYP, Teki Shala nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, ICO, KDI.

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit të Pavarur për Media dt. 12.03.2009, lidhur me rishikimin funksional dhe nivelizimin e pagave brenda KPM-së,
Të ftuar: Përfaqësuesit e KPM-së;
3. Shqyrtimi i Raportit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) për vitin 2008,
Të ftuar: Përfaqësuesit e Bordit të RTK-së;
4. Shqyrtimi i Raportit të performancës të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008,
Të ftuar: Përfaqësuesit e ZAP-së;
5. Shqyrtimi i propozim – amendamenteve të grupit punues për Projektligjin për Lizingun Financiar nr. 03/L-103;

6. **Rishqyrtimi Projektligjit nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinore, me amendamente;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi, njoftoi se pas kërkesës komisionit për plotësimin e projektit multietnik me shkresat përcjellëse që tregojnë transferin e mjeteve sipas kodeve buxhetore, ajo është sjellur dhe konsiderohet i pranueshëm propozim-vendimi i Qeverisë për këtë projekt.

Rendi ditës miratohet më plotësimin e propozim-vendimin e Qeverisë për përkrahjen e projektit multietnik në komunën e Novobërdës.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit të Pavarur për Media dt. 12.03.2009, lidhur me rishikimin funksional dhe nivelizimin e pagave brenda KPM-së

Kryesuesi, theksoi se kërkesa e KPM-së ka të bëjë me një riorganizim të brendshëm dhe si e tillë nuk përmban implikime buxhetore. Prandaj si e tillë do të mund të ishte e pranueshme për komisionin.

Argjentina, Grazhdani, theksoi se kërkesa është si rezultat i një riorganizimi dhe strukturimi që është bërë brenda Zyrës së Shefit Ekzekutiv. Është ndryshuar forma organizative e brendshme dhe si rezultat janë bërë disa gradime të punëtorëve. E gjithë kjo nuk shkakton buxhet shtesë, mjetet ekzistojnë në kategorinë paga dhe mëditje.

Naser Osmani, duke e ndërlidhur, theksoi se koeficientet e prezantuara në këtë kërkesë nuk paraqesin sqarime të mjaftueshme. Do të duhej të jepeshin sqarime se sa është paga momentale, qfarë është koeficienti, pastaj cili është ndryshimi në koeficient sipas propozimit të ri.

Arben Bilalli, në përgjigjen e parafolësit theksoi se me këto ndryshime, rritja më e lartë e pagës është ajo e shefit ekzekutiv. Përndryshe u shpreh i gatshëm të ofroj material shtesë që arsyetojnë këtë kërkesë dhe që tregojnë koeficientet nga ky ndryshim.

Riza Smaka, pasi që nuk përmban implikime buxhetore shtesë, theksoi se mbështet këtë kërkesë.

Besa Gaxheri, gjithashtu theksoi duke pasur parasysh faktin se nuk përmban implikime buxhetore shtesë mbështetë miratimin e kësaj kërkesë.

Shkumbin Demaliaj, theksoi se kërkesa nuk jep sqarime të mjaftueshme. Aty thuhet se këtij agjencioni nuk iu është aprovuar buxheti nga Qeveria sa është kërkuar, ndërsa në anë tjetër me këtë riorganizim mjetet sigurohen nga kategoria paga dhe mëditje. Materiali do të duhej të ishte më e kompletuar dhe më i pasqyruar.

Kryesuesi, për sqarim, theksoi se nuk kemi bartje nga një linjë buxhetore në tjetrën, por si rezultat i riorganizimit të brendshëm, ndryshimit të organogramit dhe avancimit të punonjësve, mjetet sigurohen brenda linjës buxhetore paga dhe mëditje.

Hajdin Abazi, theksoi se kërkesat për ngritjen e pagave krijojnë një përshtypje jo të mirë në opinionin publik duke ditur gjendjen ekonomike në të cilën gjendemi. Rritja e pagave është bërë për

gjithë shërbyesit civil duke ulur edhe tatimin në të ardhurat individuale. Ndërsa e ajo çka kërkoni ju mund të ketë implikime buxhetore në vitin e ardhshëm.

Xhevdet Neziraj, pasi që nuk përmban implikime buxhetore shtesë dhe mjetet sigurohen nga linja e njëjtë buxhetore, theksoi se mbështet këtë kërkesë.

Kosara Nikolić, duke pasur parasysh faktin se kjo kërkesë nuk përmban implikime buxhetore, theksoi se mbështetë atë.

Pasi që vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Përkrahet kërkesa e Komisionit të Pavarur për Media për rishikimin funksional dhe nivelizimin e pagave brenda KPM-së dhe si e tillë nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
- II. Komisioni kërkon nga Kuvendi të Republikës së Kosovës që të miratojë këtë kërkesë me rekomandimin që Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike të aprovonë Udhëzimin Administrativ nr.2009/01 për Organizimin dhe Strukturimin e Zyrës së Shefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media, sipas nenit 9.1. të Ligjit nr. 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media.

3. Shqyrtimi i Raportit financiar të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) për vitin 2008

Kryesuesi, njoftoi se megjithë ftesën e bërë përfaqësuesve të RTK-së për pjesëmarrje në mbledhje, ata nuk janë përgjigjur. Kjo tregon ikeje nga përgjegjësia dhe llogaridhënia. Deklarata e bëra në RTK duke kritikuar Kuvendin, kanë pasur tendencë qëllimkeqe, kur dihet se RTK i përgjigjet Kuvendi. Prandaj propozoi që raportin të mos e shqyrtojnë pa prezencën e tyre.

Naser Osmani, mendoi që raporti duhet të shqyrtohet përkundër mungesës së tyre. Nuk është shkaktar ligj për atë se çka po ndodh në RTK, por joprofesionalizmi, joserioziteti e përgjegjësve të RTK-së. Kuvendi është institucioni që duhet kërkojë llogari ndaj personave përgjegjës dhe njëherë e përgjithmonë ta vendos në rrugën e duhur funksionimin e këtij mediumi publik. Në këtë kontest do të duhej që ne si komision të nxjerrim rekomandimet se raporti është i papranueshëm dhe nuk përmbush standardet e raportimit financiar dhe se Kuvendi të ndërmarr masat adekuate konform ligjit ndaj përgjegjësve të RTK-së.

Besa Gaxheri, gjithashtu kërkoi që raporti të shqyrtohet dhe si komisioni të japim rekomandimet për Kuvendin. Raporti nuk përmbush kushtet ligjore dhe standartet e raportimit financiar. Prandaj duhet rekomandojm që ai mos të miratohet. Në bazë të kompetencës, komisioni për buxhet dhe financa është më i thirruri të kërkojë edhe ngritjen e një komisioni hetimor, prandaj kërkoj që edhe kjo të jetë pjesë e rekomandimit drejtuar Kuvendit. Mospërgjigja e ftesës tregon edhe njëherë, se ky medium nuk respekton Kuvendin dhe nuk i jep llogari atij.

Riza Smaka, theksoi se raporti nuk përmbush standarte ligjore të raportimit. Përkundër mungesës së përfaqësuesve të ftuar, komisioni duhet ta shqyrtojë atë dhe të japë rekomandimet për Kuvendin.

Kryesuesi, arsye e propozimit të tij për mosshqyrtim e tij pa prezencën e përfaqësuesve të RTK-së, ka të bëjë me faktin se ai, nuk e plotëson standartet e raportimit, nuk përmbush kushtet ligjore për raportim të parapara në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe Ligji për ndërmarrjet publike. Megjithatë theksoi se respekton vullnetin e anëtarëve që ai të shqyrtohet dhe të jepen rekomandimet për Kuvendin.

Shkumbin Demaliaj, kërkoi që raporti të kthehet mbrapa, për arsye se i njëjti përveç mos plotësimit të kushteve në pjesën financiare, ai përmban edhe të meta të shumta edhe gjuhësore.

Xhevdet Neziraj, gjithashtu përkrahu propozimet që raporti të shqyrtohet dhe komisioni të japi rekomandimet për Kuvendin. Raporti si i tillë nuk plotëson standartet e raportimit. Varësisht nga konstatimet që dalin nga shqyrtimi i tij, të shikohet mundësia edhe dhënies së rekomandimit për krijimin e komisionit hetimor.

Myrvete Pantina, vlerësoi veprim të papërgjegjshëm mospërgjigjen e ftesës nga përfaqësuesit e RTK-së. Mbështeti propozimet për shqyrtimin e tij dhe dhënien e rekomandimeve Kuvendit se raporti si i tillë nuk përmbush kushtet ligjore, pjesa financiare e së cilit nuk është në përputhje me standartet e raportimit financiar dhe i njëjti nuk duhet miratuar.

Hajdin Abazi, u shpreh i mendimit që të ipet një kohë e shkurtër shtesë, që të ftohen edhe njëherë përfaqësuesit e RTK-së, përndryshe raporti si i tillë nuk përmbush standartet ligjore. Nëse komisioni nxjerr rekomandimet për Kuvendin, të kërkohet që raporti të mos miratohet. Njëkohësisht edhe të kërkohet nga Kuvendi që të ndërmerë masa ligjore ndaj përgjegjësve të RTK-së.

Kosara Nikolić, vlerësoi të papërgjegjshme mosprezencën e përfaqësuesve të RTK-së. Raporti si i tillë nuk plotëson standartet ligjore. Komisioni nuk do të duhej të përkrah këtë raport, dhe rekomandimi i tillë duhet të jetë edhe për Kuvendin.

Naser Osmani, duke pasur parasysh faktin se raporti nuk plotëson kushtet ligjore dhe standartet e raportimit, të rekomandojmë që raporti të radhitet në rend dite dhe të kërkohet nga Kuvendi të ndërmerë masa ndaj përgjegjësve të RTK-së.

Besa Gaxheri, duke pasur parasysh kërkesat nga seanca e kaluar për sqarimin gjendjes së krijuar në RTK-së dhe ndërmerjen e masa ligjore ndaj personave përgjegjës, kjo lenë të kuptohet se ky komision duhet të rekomandoj krijimin e komisionit hetimor.

Riza Smaka, duke iu referuar të metave që përmban raporti, kërkesës nga seanca plenare, atëherë komisioni do të duhej që të rekomandoj krijimin e një komisioni hetimor për RTK-në.

Kryesuesi, papërgjegjësia ndaj ftesës së komisionit është shprehur edhe vitin e kaluar. Prandaj rekomandimi i komisionit për Kuvendin do të duhej të ishte që ky raport nuk përmbush kriteret e raportimit financiar dhe nuk është në pajtim me ligjet në fuqi dhe rregullat ndërkombëtare të kontabilitetit dhe si të tillë Kuvendi të mos e miratojë atë. Gjithashtu të rekomandohet që Kuvendi në bazë të autorizimeve që ka, konform ligjit të ndërmerë masa të caktuara ndaj përgjegjësve të RTK-së.

Pasi që vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Raporti financiar i Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2008 nuk është aprovuar nga Komisioni, sepse i njëjti nuk përmbush standartet e raportimit financiar dhe nuk është në pajtim me standartet ndërkombëtare të kontabilitetit, dhe i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që të mos e miratojë Raportin financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2008.

- II. Bazuar në pikën 1 dhe 2, Komisioni i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që në përputhje me ligjet në fuqi të ndërmarr masa të caktuar ndaj përgjegjësve të RTK-së.

3. Shqyrtimi i Raportit të performancës të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008

Kryesuesi, ia dha fjalën auditorit gjeneral të jap shpjegimet për raportin.

Lars Lage Olofsson, theksoi se pas marrjes së detyrës së auditorit, detyra e tij është që të themelojë një zyre kombëtare të auditimit, dhe të jetë anëtare e institucioneve ndërkombëtare të auditimit. Raporti i performancës tregon se kjo zyrë ende është në proces të konsolidimit të saj, zhvillimit profesional. Në këtë drejtim do të themelohet një platformë të re për këtë zyrë. Por në këtë drejtim për të arritur objektivat duhet plotësuar mungesën të resurseve dhe mjeteve financiare. Prandaj u theksoi se në fazën e rishikimit të buxhetit do të paraqes kërkesën buxhetore për plotësimin e resurseve e nevojshme për punë dhe në këtë drejtim kërkoi përkrahjen e komisionit.

Myrvete Pantina, vlerësoi raportin gjithëpërfshirës dhe i pasur me të dhëna. Megjithatë do të ishte më i kompletuar sikur të ishte bërë auditimi i jashtëm për ZAP-në. Nga auditimet e kryera një çështje brengosëse është mosrespektimi i rekomandimeve të dhanë nga ju për organizata buxhetore (vetëm 35% janë përmbushur). Pyeti qfarë masash keni paraparë që të përmissohet gjendja në këtë drejtim?

Besa Gaxheri, megjithëse vërejtje që ka pasur për këtë zyrë, nga ky raport shprehet optimizmi se gjërat kanë filluar të lëvizin për të mirë. Në raport është prezantuar gjendjen që ekziston në këtë zyrë, dhe keni shprehur vizionin për të reformuar atë, për çka edhe përgëzojë auditorin. Nga raporti shifet një shkallë e ulët e implementimit të rekomandimeve të bëra nga kjo zyrë. Po ashtu numër i ultë i auditiveve që janë bërë nga kjo zyrë për një vit. Në këtë drejtim, kërkoi që të auditohen të bëhen më shumë auditime dhe ato të përfundohen në kohë. Vlerësoi paraqitjen e pasqyrave financiare, që mund të jenë shembull për agjencionet tjera. Theksoi se pret nga ky institucion pavarësi të plotë të veprimit, prezantime reale të raporteve, ngritje profesionale dhe efektshmëri më të madhe.

Hajdin Abazi, vlerësoi prezantimin e raportit dhe shfaq shpresën se kjo zyrë do të kryej punën sa më mirë të jetë e mundshme. Theksoi se duhet prezantuar të gjitha të gjeturat nga auditimet e kryera në organizatat buxhetore, që të mund të kërkohet përmisimin i të metave. Raporti i RTK-së është një shembull i keq, që tregon nuk duhet kursyer vërejtjet dhe ndërmarrjen e masave ndaj atyre që nuk përfillin ligjet.

Riza Smaka, vlerësoi raportin si të mirë. Duke pasur parasysh faktin se keni rekomanduar për ndryshimin e ligjit, theksoi se nëse vëreni se ligji paraqet pengesë në punën tuaj, ti identifikoni mangësitë dhe të kërkoni ndryshimin dhe plotësimin e ligjit. Konsideroj shqetësuese mospërfilljen enorme të rekomandimeve nga institucionet e audituara. Në këtë drejtim do të duhej të propozoni sanksione adekuate dhe të kërkoni implementimin e tyre në afatin e caktuar.

Lars Lage Olofsson, duke u përgjigjur në pyetje, theksoi se ky është raport i performances, ndërsa raporti vjetor i kompletuar do të dërgohet në Kuvend në muajin gusht. Jemi në proces të auditimit të brendshëm, në këtë kontest të rekrutimit të auditorëve të ri, por në këtë drejtim pengesë paraqet edhe buxheti i kufizuar. Qëllimi ynë është që të ndërpritet auditimi për vitin 2008, dhe të fillojmë auditimet e vitit 2009. Do të auditojmë më shumë organizatat buxhetore që kanë rrezikshmëri më të lartë. Propozoj që komisioni të rekomandojë që konform ligjit, Kuvendi të përzgjedh auditorin e pavarur për auditimin e ZAP-së për vitin 2008-2009.

Kryesuesi, raporti i plotëson standartet ligjore dhe nga ai shifet serioziteti i juaj për të përmisuar gjërat në këtë zyrë, dhe në këtë drejtim keni përkrahjen e komisionit edhe në aspektin e sigurimit të mjeteve të mjaftueshme për punë. Kërkoj që të mos përsëritet praktika e gjertanishme e raportimit dhe në implementimin e rekomandimeve të bëra nga kjo zyrë. Përkrahu kërkesën për auditimin e jashtëm të ZAP-së dhe theksoi se komisioni në rekomandimin e vet do të kërkojë nga Kuvendi të bëjë përzgjedhjen e auditorit të jashtëm të pavarur për auditimin e zyrës suaj, për periudhën 2008-2009.

Pasi që vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I.** Raporti Vjetor i Performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008, i plotëson standartet e raportimit financiar dhe është në përputhje me standartet e ndërkombëtare të kontabilitetit, dhe i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që të miratojë Raportin Vjetor të Performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008.
- II.** Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me nenin 6.1 të Ligjit nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, të bëjë përzgjedhjen e auditorit të jashtëm të pavarur, për të bërë auditimin e Zyrës së Auditimit të Kosovës, për vitin 2008.

4. Shqyrtimi i propozim – amendamenteve të grupit punues për Projektligjin për Lizingun Financiar nr. 03/L-103

Naser Osmani, njoftoi se me ndihmën e ekspertëve dhe stafit të komisionit, grupi punues ka propozuar amendamentet me të cilat është ndryshuar dhe plotësuar projektligji. Ndryshimet nisen nga titulli duke u quajtur ligji për lizingun, në të cilin janë të rregulluar lizingu financiar dhe ai operativ. Me këto amendamente, ligji ka marrë formën e vet të duhur të rregullimit dhe zbatimit të fushës së caktuar.

Riza Smaka, vlerësoi punë e grupit punues. Megjithatë propozoi të bëhen disa ndryshime teknike. Në propozim-amendamentin 3, propozoi që të fshihet termi “letra financiare” dhe të mbetet vetëm “letra me vlerë”, sepse kemi të bëjë më të njëjtën çëshjte. Ndryshimi tjetër ka të bëjë me amendamentin 20, paragrafi 1.1 dhe 1.3 në vend të fjalisë “veprim gjyqësor”, të jetë “akt gjyqësor” dhe fjalia “në mënyrë administrative”, të zëvendësohet me “akt administrativ”.

Pasi propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I.** Miratohen propozim – amendamenteve të grupit punues për Projektligjin për Lizingun Financiar
- II.** Raporti me amendamente i procedohet Kuvendit për miratim.

5. Rishqyrtimi Projektligjit nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinore, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare të tyre.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka rishqyrtuar Projektligjin nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka rishqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinore, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

Mbledhja përfundoi në ora 13:20

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI